



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 gusht 2020
Nr. ref.:RK 1606/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI185/19

Parashtrues

Abdylhadi Petlla

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0034, të 27
qershorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Abdylhadi Petlla nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0034, të 27 qershorit 2019 (në tekstin e mëtejme, DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 tetor 2019, Parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje iu dërgua DHPGJ-së.
8. Më 9 qershor 2020, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga parashtruesi i kërkesës dhe DHPGJS-ja.
9. Më 12 qershor 2020, DHPGJS-ja dorëzoi dokumentet e kërkuara.
10. Më 22 korrik 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 14 qershor 2002, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren për anulimin e kontratës së shitblerjes me Komunën e Prizrenit, të lidhur më 3 mars 1966, duke kërkuar dorëzimin në posedim dhe

- shfrytëzim të paluajtshmërisë në vendin e quajtur “Fusha e Levishës”, kulturë kopsht, klasë III, në sipërfaqe prej 43.45 ari. Parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se kontrata e lartpërmendur ishte lidhur nën kushte të presionit dhe kërcënimit nga “pushteti i atëhershëm”.
12. Më 10 shtator 2004, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar precizimin e padisë, duke kërkuar që t’i jepet në pronësi një ngastër kadastrale tjetër, në vend të ngastrës së sipërpërmendur.
 13. Më 12 prill 2007, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar plotësim të procedurës së provave, me shikim të fletë posedimit të ngastrës kadastrale, të bëhet dalja e gjykatës në vend, të merret mendimi i ekspertit të gjeodezisë dhe mendimi i ekspertit të bujqësisë.
 14. Më 23 mars 2010, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykim C.nr.371/02, miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke detyruar Komunën e Prizrenit që, në pamundësinë e kthimit të ngastrës kadastrale në vendin e quajtur “Fusha e Levishës”, t’i bartë parashtruesit në pronësi, posedim, ngastrën kadastrale të regjistruar si kullosë e klasës II, në vendin e quajtur “Mazno kamenje-lumi”. Nga Komuna e Prizrenit u kërkuar që të lejoj regjistrimin në librat kadastral dhe të dorëzoj ngastrën kadastrale në fjalë në posedim dhe shfrytëzim të lirë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.
 15. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, Komuna e Prizrenit ushtroi ankesë, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më 1 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), gjithashtu paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur, duke pretenduar se është kundërthënë me vetveten dhe arsyet e dhëna.
 16. Më 5 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktvendim Ac.nr.505/2010, miratoi ankesat e komunës së Prizrenit dhe AKP-së dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.371/02, të 23 marsit 2010 dhe lëndën e ktheu në rigjykim në shkallë të parë. Gjykata e Qarkut vlerësoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare dhe se nuk është vërtetuar legjitimiteti i të paditurës: Komuna e Prizrenit.
 17. Më 26 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C.nr.1061/12, u shpall jo kompetente për të vendosur për këtë çështje, duke e referuar lëndën në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKP, si gjykatë kompetente. Në procedurën pranë DHPGJS, si paditës paraqitet Abdylhadi Petlla (parashtruesi i kërkesës), ndërsa si të paditur, Progres Export-Arbanë dhe AKP.
 18. Më 7 shtator 2016, DHPGJS, përmes një urdhri, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që brenda afatit prej 20 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit të dorëzojë vendimin e trashëgimisë. Në atë urdhër parashtruesi i kërkesës ishte paralajmëruar se në rast se nuk i përgjigjet urdhrit, DHPGJS do të hedh padinë të papranueshme.

19. Më 19 shtator 2016, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kishte njoftuar DHPGJS se më 28 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës i kishte tërhequr autorizimin dhe nga ajo kohë ai nuk është përfaqësues i parashtruesit të kërkesës.
20. Më 21 shtator 2016, DHPGJS-ja kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë vendimin e trashëgimisë në mënyrë që të vërtetohet “legjitimiteti real aktiv” i palëve në procedurë, që është kusht procedural që një padi të jetë e vlefshme për të vazhduar procesi gjyqësor.
21. Më 26 shtator 2016, urdhri i lartpërmendur i ishte dërguar dhe ishte pranuar nga parashtruesi i kërkesës, por ai nuk kishte dorëzuar asnjë përgjigje në DHPGJS.
22. Më 12 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJ-së, me Aktvendim C-III-13-0116, e hodhi poshtë padinë si të papranueshme, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur ta dorëzojë aktvendimin e trashëgimisë të kërkuar me urdhrin e lartpërmendur. Në këtë Aktvendim, Kolegji i Specializuar i DHPGJ-së kishte theksuar: “(i) se padia e kompletuar me faktet materiale është një kusht i pranueshmërisë; (ii) DHPGJS-ja kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë dëshminë e trashëgimisë duke i dhënë kohë të mjaftueshme; (iii) parashtruesi i kërkesës kishte pranuar urdhrin për dorëzim të dëshmisë për trashëgimi, mirëpo, kishte zgjedhur që të mos e dorëzojë atë deri në marrjen e vendimit nga DHPGJS-ja; dhe, se (iv) DHPGJS-ja nuk mund të supozojë se parashtruesi i kërkesës është i vetmi trashëgimtar ligjor i paraardhësit të tij, derisa ai nuk e dëshmon me vendim të trashëgimisë”.
23. Më 7 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë, kundër aktvendimit të lartpërmendur, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkëljes së dispozitave procedurale. Parashtruesi i kërkesës kishte ofruar si provë : certifikatën, e lindjes së Abdulhadi Petlla (parashtruesit), certifikatën e vdekjes së A.P., (nëna e parashtruesit), si dhe aktvdekjen e E. J. Sh., në të cilën si trashëgimtar i mundshëm i tij paraqitet djali i motrës, gjegjësisht parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se urdhri për dorëzim të aktvendimit për trashëgimi nuk e ka pranuar asnjëherë. Ai po ashtu kishte pohuar se ish pronari i paluajtshmërisë kishte vdekur në vitin 1965 dhe ishte trashëguar nga motra e tij, A.P., ndërsa pasardhës i saj është vet parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar kompensimin e pronës me një pronë tjetër, pasi që prona që i ishte marrë paraardhësit të tij i ishte dhënë dikujt tjetër.
24. Më 1 gusht 2018, AKP-ja paraqiti përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, duke pohuar se nga provat e dorëzuara nuk vërtetohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe se ato pretendime nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk mbështeten me prova dhe fakte bindëse.
25. Më 27 qershor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS, nxori Aktvendimin AC-I-17-0034, dhe e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-III-13-0116, të 12 janarit 2017. Kolegji i Apelit i DHPGJS vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk e

ka rregulluar çështjen e trashëgimisë, sepse atij i ishte dhënë mundësia që ta dorëzon aktvendimin për trashëgimi, për ta vërtetuar legjitimitetin e tij aktiv, mirëpo ai kishte dështuar që ta dorëzojë dokumentin në fjalë. Kolegji i Apelit i DHPGJS shtoi se aktvendimi për trashëgimi është i vetmi dokument në bazë të nenit 171.1, lidhur me nenin 178.1, të Ligjit për Procedurën Jo-kontestimore, që vërteton legjitimitetin aktiv në procedurë.

26. Më 24 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës i propozoi Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-17-0034, të 27 qershorit 2019.
27. Më 26 shtator 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me Njoftim KMLC.nr.159/2019, njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij nuk ishte pranuar, sepse nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit po ashtu njoftoi parashtruesin e kërkesës se, duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 15 të Ligjit nr. 06/l-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ai mund të paraqiste kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim të kushtetutshmërisë së cilitdo vendim ose aktgjykim të DHPGJS, ose cilësdo gjykate tjetër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e DHPGJS në rastin e tij kanë shkaktuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Për të gjitha, palës Abdylhadi Petlla, i ka mbetur që Gjykata Kushtetuese, t’ia aprovoj kërkesën e parashtruar, duke shqyrtuar kushtetutshmërinë e Aktvendimit AC-I-17-0034 të dt. 27.06.2019, të DHPGJS, sepse iu ka shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe procedim të drejtë, e garantuar kjo e drejtë sipas Kushtetutës së R. të Kosovës”.*
30. Lidhur me aktvendimin e trashëgimisë, Parashtruesi i kërkesës pohon: *“në këtë situatë është me rëndësi të ceket, se paditësi, në lidhje me këtë çështje juridike, nuk ka pranuar as këtë urdhër dhe asnjë shkresë tjetër...sepse konstatimi në faqen e katërt në kryeradhën e fundit është imagjinar dhe jo real”.*
31. Lidhur me veprimet e përfaqësuesit të tij, Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“[...]realiteti është, se paditësi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe befasohet se si të qëndroj ky konstatim, pastaj në aktvendim, nuk thirret cila parashtrësë, dhe ku është nënshkrimi i paditësit, çfarë jep të kuptohet se janë evidente shkeljet në dëm të paditësit [...]”.*
32. Parashtruesi i kërkesës nuk ngre ndonjë pretendim kundër Njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [KMLC.nr.159/2019], të 26 shtatorit 2019.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR PROCEDURËN JOKONTESTIMORE Nr. 03/L-007

Aktvendimi për trashëgimin

Neni 171

171.1 Kur gjykata në procedurën trashëgimore konstaton se cilëve persona u takon e drejta për trashëgim, do t'i shpall këta persona trashëgimtarë me anë të aktvendimit të vet për trashëgim.

Neni 178

178.1 Konsiderohet se me anë të aktvendimit për trashëgimin që ka marrë formë të prerë është konstatuar se çka hynë në pasurinë trashëgimore, se kush është trashëgimtar i të vdekurit, sa është e madhe pjesa e pasurisë që i takon, se a i është kufizuar apo ngarkuar e drejta e trashëgimit dhe në cilën mënyrë, si dhe se a ekzistojnë dhe cilat të drejta të legatit ekzistojnë. E gjithë kjo vlen edhe për aktvendimin e pjesshëm për trashëgim në pikëpamje të asaj që është konstatuar me anë të tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

35. Në vazhdim, Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjkata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit **[Kërkesa individuale]**

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjkata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0034, të 27 qershorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Më tutje, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
38. Gjykata vëren se parashtruesi e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës.
39. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon: (i) se kurrë nuk ka pranuar urdhrin për dorëzim të aktvendimit për trashëgimi; (ii) se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim nëpërmjet përfaqësuesit të tij.
40. Gjykata, fillimisht, vë në dukje se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmërisë i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

41. Në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJ-së vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte sqaruar çështjen e trashëgimisë. Atij i ishte dhënë mundësia nga ky Kolegj që ta dorëzonte aktvendimin për trashëgimi, për ta vërtetuar legjitimitetin e tij aktiv, mirëpo ai kishte dështuar që ta dorëzojë dokumentin në fjalë. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së po ashtu kishte sqaruar se aktvendimi për trashëgimi është i vetmi dokument, në bazë të nenit 171.1 lidhur me nenin 178.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, që vërteton legjitimitetin aktiv në procedurë të kësaj natyre.
43. Në këtë drejtim, pjesa kryesore e e aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së përcakton: *“Në rast të një padie në lidhje me të drejtat mbi një pasuri të trashëguar, Gjykata duhet të shqyrtojë ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Aktvendimi i Trashëgimisë është dokument i vetëm për të treguar dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pozitën trashëgimore dhe duhet të kërkohet nga paditësit sa më parë që lind ndonjë dyshim se jo të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar si paditës për rastin në fjalë. Nëse Aktvendimi i Trashëgimisë nuk është paraqitur, brenda afatit të arsyeshëm, padia duhet hedhur poshtë si e papranueshme. Legjitimiteti aktiv i paditësit duhet të shqyrtohet menjëherë sepse kjo do të jetë një humbje e kohës dhe burimeve që të shkoj më tej për aq kohë sa nuk është e qartë nëse paditësi mund të jetë bartës i së drejtës që ai e pretendon. Nëse ai nuk mund të jetë bartës i së drejtës të cilën e pretendon atëherë padia duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme. Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësi nuk e ka rregulluar çështjen e trashëgimisë. Paditësit i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes urdhrit të dorëzuar tek paditësi me, datën 26/09/2016 të dërgojë Aktvendimin e trashëgimisë për të vërtetuar legjitimitetin e tij aktiv, mirëpo ai ka dështuar ta dorëzojë këtë dokument. Prandaj pretendimi ankimor i ankuesit se nuk pranuar urdhër asnjëherë është paqëndrueshëm sikundër edhe pohimi se është pa përfaqësues profesional. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi i Trashëgimisë është i vetmi dokument në bazë të nenit 171.1 lidhur me nenin 178.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore, i cili vërteton legjitimitetin aktiv në procedurë”*.
44. Më tutje, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, sepse ai kishte dështuar që ta përmbush kushtin ligjor për shqyrtim të padisë së tij në pajtim me nenet 171.1 dhe 178.1 të Ligjit për Procedurë Jokontestimore, e që është dorëzimi i aktvendimit për trashëgimi.
45. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se parashtruesit të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideron të rëndësishme për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestoj në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar

objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, *Parashtrues Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

46. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontesti civil (shih përshtatshmërisht rastet: KI118/17; KI142/15).
47. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (Shih, për shembull, rastin KI42/16, *Parashtrues Valdet Sutaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
48. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli parësor i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, për shembull rastin KI70/11, *parashtrues të kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
49. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngre pretendim të argumentueshëm kushtetuese për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, *parashtruese e kërkesës Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
50. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

51. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi